



P R O C E S V E R B A L I

Mbledhja e Komitetit për Komunitete e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më datë: **22.06.2026**, me fillim në orën **10:00**. Këtë mbledhje e kryesoi kryesuesja e komitetit, **Genta Morina**.

Kryesuesja: Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! Faleminderit për kontributin dhe praninë tuaj. Përshëndetje për zëvendëskryesuesin, për shefin e ZKKK-së, për përfaqësuesit e KFOR-it, OSBE-së, për anëtarët e Komitetit për Komunitete dhe të për gjithë të pranishmit. Ky është takimi **i tretë** për vitin 2026. Për takimin e sotëm i kemi këto pika të rendit të ditës:

R E N D I T E

1. **Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Informatë nga ZKKK-ja, rreth punës për vitin 2025;**
3. **Të ndryshme;**
4. **Vizitë në Lagjen e Epërme ku jeton komuniteti joshumicë.**

Kryesuesja: Atëherë, besoj që materialin e keni pranuar me kohë. Ky është rendi i ditës për sot. Nëse dikush nuk ka diçka për të thënë? Nëse jo, si të tillë po e vendosim në votim! Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë unanime votohet rendi i ditës.

1. **Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:**

Kryesuesja: A ka dikush diçka rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar?... Kush është “për”?... Unanimisht miratohet pika e parë.

2. **Informatë nga ZKKK-ja, rreth punës për vitin 2026:**

Lendrit Qeli: Përshëndetje për të gjithë! E nderuara kryesuese, ju anëtarë të Komitetit për Komunitete, përfaqësues nga OSBE dhe KFOR-i. Fillimisht një korrigjim të vogël: unë kam arritur t’i marr dy raporte, sepse këtu është kërkuar raporti për vitin 2025, megjithatë do të duhej ndoshta të diskutojmë për gjysmën e parë të vitit 2026, sepse komiteti legjitimitetin e tij e ka fituar këtë vit. Me vete i kam të dy raportet dhe në vija të trasha do të mundohet t’i prezantojë këtu para jush. Sa i përket raporti vjetor për punën janar-dhjetor 2025, konsideroj që kemi pasur zhvillime të ndryshme në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim. Disa prej projekteve në arsim, në bashkëpunim me organizatën IOM dhe bashkëfinancimin e ZKKK-së, në shkollën e mesme të ulët “Katër Dëshmorët” në Ratkoc, është bërë instalimi i pajisjeve moderne të kabineteve (fizikë, biologji, kimi), sepse në këtë shkollë ka mjaft nxënës të komuniteteve joshumicë, pas shkollës “Gëzim Hamza-Piktori”. Në fushën e arsimit, sa i përket nxënësve të komunitetit joshumicë, gjithmonë kemi asistuar dhe me bursa (10 nxënës), duke u asistuar edhe për dokumentacion përmes E-Kosovës. Mund të themi që edhe viti 2025, si dhe fillimi i 2026 konsiderohen pak si vite të brishta për zyrën tonë, sepse në proces të tenderimit janë bllokuar dy projekte që i kemi pasur të planifikuar për infrastrukturë, në Hoçë të Madhe dhe në fshatin Krushë e Madhe. Çdo gjë ka qenë gati, por për shkak të kontratës kolektive dhe përmbaruesit privat, jemi prekur edhe ne si zyrë. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, përveç përkushtimit kryesor që e ka për komunitetet joshumicë, merret edhe me riatdhësim, si dhe kthimi i qëndrueshëm. Në koordinim me ministrinë e Punëve të Brendshme, brenda Komunës

së Rahovecit ekziston komisioni për riadhesim, ku me sukses kemi trajtuar raste të ndryshme të ndjeshme. Sa i përket çështjeve të tjera, vlen të theksohet që për herë të parë është krijuar Kolegji i Zyrave Komunale për Komunitete dhe Kthim, një zë i veçantë për mbrojtjen e interesave të ZKKK-së. Ky kolegji është udhëhequr nga Komuna e Rahovecit, sepse vetë iniciativa ka ardhur nga ne. Qëllimi është që kjo zyrë në të ardhmen ta ketë buxhetin e saj dhe ndoshta edhe ngritjen e kapaciteteve të veta, në staf dhe në çështje të tjera përcjellëse. Në kolegji ka qenë i ftuar kryeministri i Republikës së Kosovës dhe ministrat përcjellës, të cilët e bëjnë monitorimin e zyrës sonë. Sa i përket çështjes së bashkëpunimit: Zyra komunale për Komunitete dhe kthim, do të duhet të kishte raporte bashkëpunuese me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, kjo e fundit nuk bashkëpunon fare dhe pothuajse të gjitha informatat i marrim përmes mediave. Për këtë qëllim është krijuar edhe kolegji, për mbrojtje të interesave të ZKKK-ve. Po provojmë edhe ta ndryshojmë udhëzimin administrativ për ZKKK-në, sepse është i vitit 2010 dhe nuk përkon me gjendjen që tani e kemi me komunitete. Zyrës sonë së shpejti do t'i shtohet edhe një dikaster tjetër që do të jetë "Migracioni dhe të huajt". Më gjerësisht, raportin e keni të publikuar në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryesuesja: Faleminderit për këto informata, Lendrit!

3. Të ndryshme:

Kryesuesja: Te pika e tretë, nëse dikush ka diçka për të thënë, jemi të hapur?... Nëse jo, atëherë kalojmë te pika e katërt për një sqarim.

4. Vizitë në Lagjen e Epërme ku jeton komuniteti joshumicë:


Kryesuesja: Sa i përket kësaj vizite, ju njoftoj që përfaqësuesi i Lagjes së Epërme, z. Bashkim Zogaj, më ka lajmëruar që sot e ka një rast familjar dhe është zënë. Kërkoj mirëkuptim që këtë vizitë ta realizojmë në mbledhjen e radhës. Ju falënderoj për kontributin tuaj. Ky është fundi i mbledhjes së tretë! Shihemi!

Mbledhja përfundoi: 10:30

Procesmbajtësi


Albion Krasniqi

Kryesuesja e mbledhjes


Genta Morina

